



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Komuna e Drenasi  
611-22-4515-1-1-1/C572



KONTRATË FURNIZIMI- VLERE E MADHE

KUSHTET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

**TITULLI: Furnizim me paisje mjekësore për shërbimin e radiologjisë**

Numri identifikues: 611-22-040-111, Përgatitur në Drenas, 16.08.2022 Nr. i arkivit:02—400-43236

**PALËT NË MARRËVESHJE**

KOMUNA E DRENASIT - DRENAS, përfaqësuar nga GEZIM HAJDINI, Zyrtar i Prokurimit ( më tutje "Punëdhënës")

**KosovaMed Healthcare SH.P.K., Rr. Ndue Përlleshi K.P. , Lok. Nr.1, Prishtinë, PRISHTINË**  
përfaqësuar nga: **Kastriot Asllani** (më tutje "Kontraktues")

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë: nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

**Furnizim me paisje mjekësore për shërbimin e radiologjisë**

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë: 45 DITE nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

1.1 2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: INSTITUCIONET SHENDETSORE TE KOMUNES SE DRENASIT

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimitin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total I furnizimeve duhet të jetë: **270 000,00 €**; [DY QIND E SHTATEDHJETE MIJE / Euro.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

[Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim:

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;

- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

## PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekt i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruarit e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 "Çmimi i kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 "Shërbimet pas shitjes" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve,

20

sigurimi i pjeseve rezerve qe i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime te ngjashme ne lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Furnizuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

## Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera

te ketyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, ne rast se ato mund te gjenden. Pas lesimit te certifikates se garancisë, ose pas pranimit final te saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues te gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera te kontrates.

5.2 Përveç nese është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

#### Neni 6 Ndhurma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkuara ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendosë që të marrë lejet e kërkuara apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

#### Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçeltësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

#### Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

#### Neni Siguria e ekzekutimit

9.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

9.3 Përveç asaj pjese të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet

*BU*

brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikates se perkohshme te pranimit.

#### Neni 10 Sigurimi

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet te jene te siguruara plotësisht me një valute lirisht te konvertueshme kunder humbjes ose dëmimit te rastësishëm te prodhoj ose blejë, transportoj, ruaj dhe shpërndaj ne mënyrën e specifikuar ne KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta për dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

#### Neni 11 Programi i realizimit

11.1 Nëse kërkohet në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përmbajë së paku këto:

- i) rendin sipas të cilit Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe
- ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsye autoriteti kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojnë limitin kohor brenda të cilit programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe afatin e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesi nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin te njoftoj vendimin e tij te aprovimit i përmendur ne Nenin 11.2 brenda afateve te përmendura ne kontrate programi i tille i realizimit duhet te konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Ne qofte se nuk ka afat te caktuar, ato do te konsiderohet te aprovuara 30 dite pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim te ai.

11.5 Para pranimit të perkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi duhet të furnizoj me manualet e funksionimit dhe mirëmbajtjes së bashku me vizatime, të cilat do të jenë në detaje të tilla që do të mundësoj Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajtjen, rregullimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve të furnizimeve. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, manualet dhe vizatimet do të jenë në gjuhën e kontratës dhe në forma dhe numrat të tilla të deklaruar në kontratë. Furnizimet nuk do të konsiderohen të përfunduara me qëllim të pranimit të perkohshëm deri sa manualet dhe vizatime e tilla janë furnizuar Autoritetit Kontraktues

#### Neni 12 Marrëveshjet tatimore dhe doganore

12.1 Duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të përcaktuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifave doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

#### Neni 13 Patentat dhe licencat

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkëlja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

#### Neni 14 Periudha e ekzekutimit të detyrave

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtëm me Nenin 2, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin për dëmin që ka pësuar. Furnizuesit do ta humb këtë te drejtë përveç nëse

200

ai e ushtron ate brenda 30 diteve nga data e skadimit te periudhes 30 ditesh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit për sasi të ndara, këto periudha nuk do të mbliidhen në rastet kur një Furnizuesi i jepen më shumë se një sasi.

#### Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues porositi furnizime ekstra ose plotësuese;
- b) Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- c) Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- d) Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përveç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- e) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- f) Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- g) Forca madhore;
- h) Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospective ose retrospective, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

#### Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

#### Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdher administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- a. prodhimin e furnizimeve;
- b. dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- c. instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- a) Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- b) është i nevojshëm për arsye të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;
- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në çmimin e kontratës përveç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkitazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse periudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njoftuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përmbajtësore, parregullsive ose mashtrimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtrime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtrimit.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përmbajtësore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtrimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përmbajtësore ose parregullsitë do të jenë të gjitha shkelle të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

## Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të jenë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkesë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkesë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuara për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit

220

mund t'i jepet mundësia t'i riparoje dhe t'i permiresoje materialet dhe artikujt qe jane retuzuar, por keto materiale dhe artikuj do te pranohen per inkorporim ne furnizime vetem nese jane riparuar dhe jane permiresuar ne ate menyre qe te jete i kenaqur autoriteti kontraktues.

#### Neni 19 Inspektimi dhe testimi

19. Furnizues do te siguroje qe furnizimet te dorëzohen ne vendin e pranimi me kohë qe t'i mundësohet autoritetit kontraktues te vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitë qe mund t'i hasë ne këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet qe te paraqesë ndonjë arsye për vonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do te ketë te drejtë qe herë pas here te inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe te kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit te çfarëdo artikulli qe përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë qe te përcaktojë nese komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do te bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimi apo në vendet qe janë specifikuar në KVK.

19.3 Për qëllime të testeve dhe inspektimeve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, për kohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit qe zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

19.4 Nëse përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet qe, përveç nese ka marrë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, te vazhdojë testimin, i cili do te konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuarat si duhet te rezultateve të testit te Autoriteti kontraktues, nese nuk ka qenë prezent gjatë testit, do t'i pranojë rezultatet e testit.

19.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

19.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund te kërkojnë qe këto teste te përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nese ndonjëra palë kërkon, te testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do te jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do te bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

19.7 Gjatë realizimit të detyrave të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, te cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

#### Neni 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do te bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës qe duhet t'i behet Furnizues sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

20.2 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Furnizues do te bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate qe e plotëson Furnizuesi. I njëjti formular, qe i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet te përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet te paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do te jete data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do te jete e pranueshme nese nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

*M*

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 20.3, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

20.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 20.3 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

## Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të jenë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

21.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqësimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashpër, ekspozimin në temperatura ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transitit.

21.3 Paketimi, shënimi dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet të jenë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtrohen ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi të ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

21.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

## Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- a) heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- b) zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- c) heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjeshme të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtërinë ose dizajnin për të cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është në pajtim me kontratën;
- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuara apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë në pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

22.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektet e specifikuar. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhrave, Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të

punesoje persona tjere per t'i zbatuar urdhrat dhe te gjitha shpenzimet qe jane pasoje e kesaj, apo qe do te shfaqen per shkak te kesaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do të paguhen ose të cilat do të bëhen obligim për t'iu paguar Furnizuesit.

22.4 Furnizimet që nuk janë të cilësisë së kërkuar do të refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet të jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo të ndikojë në vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do të hiqen me të drejtë me shpenzim dhe me rrezik të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do të refuzohen.

#### Neni 23 Pranimi i përkohshëm

23.1 Furnizimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të jenë dorëzuar në pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet e kërkuara, dhe të jenë autorizuar, si dhe të jetë lëshuar një certifikatë e pranimit të përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

23.2 Furnizuesi mund të bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm atëherë kur furnizimet të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit të furnizuesit do të veprojë sipas njëres nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar furnizimet në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij e kërkon Furnizuesi për ta lëshuar certifikatën.

23.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë të pamundur që të vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar për pranim të përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë për ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, në konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do të përgatitet brenda 30 ditësh pas datës në të cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do të nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave për të evituar obligimin e paraqitjes së furnizimeve në një gjendje të përshtatshme për pranim.

23.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe, përveç në rastet kur certifikata e pranimit të përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë të pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë në pjesë, Furnizuesi do të ketë të drejtë të bëjë kërkesë për certifikatë të veçantë për secilën pjesë.

23.5 Në raste të dorëzimit të pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën për të dhënë pranim të pjesshëm e të përkohshëm.

23.6 Pas pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

#### Neni 24 Obligimet për garanci

24.1 Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale, përveç nëse kërkohet ndryshe në kontratë. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do të mbetet e vlefshme në atë mënyrë që saktësohet në KVK.

24.2 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve në ndonjë pjesë të furnizimeve të cilat mund të paraqiten, apo të ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe të cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo të mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose

*RLL*

c) shfaqen gjate ndonje inspektimi te bere nga Autoriteti kontraktues ose ne emer te tij.

24.3 Furnizuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo të mund të praktikohet. Periudha e garancisë për të gjithë artikujt e ndërruar ose të riparuar do të fillojë përsëri nga data në të cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit të autoritetit kontraktues. Periudha e garancisë do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

24.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë k Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor të paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të korrigojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rrezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhet ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- b) në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- c) të ndërpresë kontratën.

24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

## Neni 25

## Shërbimet pas-shitjes

25.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- a) pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kuptuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- b) në rast të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuara dhe, pas ndërprerjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

## Neni 26

## Pranimi përfundimtar

26.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 24 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

26.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

26.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## Neni 27

## Shkelja e kontratës

27.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

*P.L.*

a) demet; dhe/ose

b) ndërprerjen e kontratës.

27.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

a) dëme të përgjithshme; ose

b) dëme të likuidueshme.

27.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 28 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbytëse nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;

b) Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;

c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e parapare në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;

g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;

i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;

j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;

l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përbushjen duhet të pushohet së ekzistuari menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të jenë paraqitur tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të

RR

Furnizuesit ose te pertaqesuesve te tij ose duke u bere atyre thirrjen e duhur, do ta pergatise nje raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të përdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të jenë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

#### Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

29.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumën që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 29.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

#### Neni 30 Forca madhore

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë madhore që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektivit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhe 29, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

#### Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që

*Ru*

mund të ndodhin ndermjet tyre. Dapo të shtaqet ndonje mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njera tjetren me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetren.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

### PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	<b>Furnizim me paisje mjekësore për shërbimin e radiologjisë</b>
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë <i>(SHQIPE)</i>
Siguria e ekzekutimit	9.1	10 % e vlerës së kontratës, validiteti 75 dite
Sigurimi	10.1	Nuk kërkohet.
Programi i ekzekutimit	11.1	5 ditë pas nënshkrimit të kontratës
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	Të gjitha duhet të paguhet nga Kontraktuesi





*PO*

Patentat dhe licencat	13.1	Sipas specifikonit të përshkruar në Neni 13 i KPKJ
Cilësia e furnizimeve	18.1	Furnizimet duhet të jenë konform specifikime të kërkuara duke përfshirë Furnizimet duhet të kryhen brenda afatit të paraqitur ne ofertë.
Inspektimi dhe testimi	19.1	Inspektimin e kryen Institucionet Shendetsore sa herë që ka nevojë me shpenzime të kontraktuesit.
Pagesa	20.1	Autoriteti kontraktues do t'i paguajë Kontraktuesit shumën e obligimit brenda [30] ditësh pas datës në të cilën është regjistruar pagesa e pranueshme, Menaxhimin e kësaj kontrate e Kryen Menaxheri i Projektit dhe mbikqyrsi caktuar me një Vendim nga Kryetari i Komunës , i cili e harton një Plan të Menaxhimit të kontratës konform Neni 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 Afati i furnizimeve duhet të kryhet sipas afatit të prezentuar nga Ofertuesi. Në komisione të pranimit nuk duhet të caktohen personat që kanë marrë pjesë në hartimin e specifikimeve dhe ata të cilët kanë marrë pjesë në vlerësimin e ofertave.
Dorëzimi	21.2	<b>Furnizim me paisje mjekësore për shërbimin e radiologjisë</b> Per Institucionet shendetsore te K.K Drenas përkatësisht tek Menaxheri i Projekti mbikqyrsi i drejtperdrejt dhe Komisioni pranues.
Obligimet e garancionit pas pranimit të paisjeve	24.1	Garancioni per eliminimin e defekteve
Monitorimi	24.2	Menaxheri i projektit duhet të jetë pjesë e Planit të Menaxhimit të kontratës dhe obligohet që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor ta kryej sa herë që kërkohet ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar.Poshtu merrë përsipër të përballet (së bashku me Avokatin komunal) me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.
Shërbimet pas shitjes	25.1	N/A
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Mundesisht në mes të dy palëve..
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Ekonomike e Qarkut - Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.
Pagesat	33.1	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtarja për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për punët e kryera do të caktohet nga Menaxheri i Projektit.


Dorëzimi i dokumentave	33.2	I e gjitha pagesat mund te kryhen nga Zyrtarja per pagese vetem nese jane otruar dokumentet si: Plani i Menaxhimit, aktvendimet, procesverbalet, raportet, situacionet për punët e kryera, faturat, atestimi, shkresat, fletët e ditarit të punës, sigurimet etj.
Arkimi i dokumentave	33.3	Zyrtarja për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertes, t'i arkivoj dhe ruaj.Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.Një kopje e faturës, raportit të pranimit dhe kontratës pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen tek Zyrtarja për rexhistrimin e pasurisë.
Hyrja në fuqi	33.4	Kontrata hynë në fuqi menjeher pas nënshkrimit të palëve. Kontrata hartohet në 2 kopje origjinale.

Kësaj kontrate i bashkangjitet:

- a. Oferta financiare e Tenderuesit , b) Afati i furnizimit , C) sigurimi i ekzekutimit

<b>Emri:</b>	<b>Gezim Hajdini</b>	<b>Emri:</b>	<b>Ramiz Lladrovci</b>
<b>Pozita:</b>	<b>Zyrtar Pergjegjës i Prokurimit</b>	<b>Pozita:</b>	<b>Zyrtar Kryesor Administrativ</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<b>16.08.2022</b>	<b>Data:</b>	<b>16.08.2022</b>
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

Për Kontraktuesin

<b>Emri:</b>	<b>Kastriot Asllani</b>
<b>Pozita:</b>	<b>Drejtor</b>
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<b>16.08.2022</b>
<b>Vula:</b>	

## PARAMASA DHE PARALLOGARIA

**FURNIZIM ME UPGRADE, PJESE DHE PANEL TE GJERE DHE TE MESEM PER SISTEMIN FDR Smart FGXR ekzistues, RU 392 Tm në QKMF-Drenas dhe Sistemi Imazherik i leximit mjekut dhe radiologut në QKMF, QMF dhe AMF**

Nr.	Emërtimi	Nj mat.	Sasia	Çmimi	Shuma me TVSH
1	<b>Detector Size minimum 17x17 inches or more, Original for FujiFilm X Ray and Software</b>	copë	1	68.000,00	73.440,00
	<i>Technology should be minimum CSI</i>				
	<i>Pixel resolution <math>\leq 150\mu\text{m}</math></i>				
	<i>Should support onsite installed modules as</i>				
	<i>Gradation Processing (GP)</i>				
	<i>Frequency Processing (FP)</i>				
	<i>Dynamic Range Control processing (DRC)</i>				
	<i>Flexible Noise Control (FNC)</i>				
	<i>Multi-objective Frequency Processing (MFP)</i>				
	<i>Grid Removal Processing (GPR)</i>				
	<i>Shuttering Processing</i>				
	<i>Virtual Grid Processing (VGP)</i>				
	<i>Dynamic Visualization II Processing (DYN)</i>				
	<i>Medical adapter for detector and battery charger</i>				
	<i>Battery pack</i>				
	<i>DC power cable</i>				
	<i>Installation of the panel is mandatory, including licenses (original), new panel addition</i>				
	<i>IP configuration of the system, powering up and Phantom Calibration</i>				
	<i>Dose Calibration of the X-ray beam to the panel</i>				
2	<b>Detector Size minimum 14x17 inches or more, Original for FujiFilm X Ray and Software</b>	copë	1	57.500,00	62.100,00
	<i>Technology should be minimum CSI</i>				
	<i>Pixel resolution <math>\leq 150\mu\text{m}</math></i>				
	<i>Should support onsite installed modules as</i>				
	<i>Gradation Processing (GP)</i>				
	<i>Frequency Processing (FP)</i>				

	<i>Dynamic Range Control processing (DRC)</i>				
	<i>Flexible Noise Control (FNC)</i>				
	<i>Multi-objective Frequency Processing (MFP)</i>				
	<i>Grid Removal Processing (GPR)</i>				
	<i>Shuttering Processing</i>				
	<i>Virtual Grid Processing (VGP)</i>				
	<i>Dynamic Visualization II Processing (DYN)</i>				
	<i>Medical adapter for detector and battery charger</i>				
	<i>Battery pack</i>				
	<i>DC power cable</i>				
	<i>Installation of the panel is mandatory, including licenses (original), new panel addition</i>				
	<i>IP configuration of the system, powering up and Phantom Calibration</i>				
	<i>Dose Calibration of the X-ray beam to the panel</i>				
3	<b>Detector size minimum 10 x 12 inches or more, Original for FujiFilm X Ray and Software</b>	copē	1	54.500,00	58.860,00
	<i>Wireless technology</i>				
	<i>Technology of imaging should be CSI</i>				
	<i>Unit should come with at least one battery for each panel and charge solution</i>				
	<i>Pixel Resolution 1920 x 1536 pixels</i>				
	<i>ISS technology</i>				
	<i>System should store minimum 180 images</i>				
	<i>Installation of the panel is mandatory, including licenses (original), new panel addition</i>				
	<i>IP configuration of the system, powering up and Phantom Calibration</i>				
	<i>Dose Calibration of the X-ray beam to the panel</i>				
4	<b>Vertebral Scoliosis Cassette and Software License</b>	copē	1	54.200,00	58.536,00
	<i>Original Cassese for Fujifilm X Ray CR model Prima Tm</i>				
	<i>LC Cassette Type with minimum size 35 x124 cm ore more</i>				
	<i>3ple set of IP STVI minimum 35x43 cm</i>				
	<i>Software to perform long-view imaging of the entire length of the vertebra</i>				
	<i>Accessories including holder should be offered</i>				
	<i>Dose Calibration of the X-ray beam to the Scoliosis cassette should be</i>				
5	<b>Doctor and Radiologist Reading System</b>	copē	1	15.800,00	17.064,00
	<i>VNA integration of FujiFilm Devices</i>				
	<i>Compatibility to EPR/RIS/PACS</i>				
	<i>Vendor-neutral archive</i>				
	<i>DICOM and non-DICOM images integration</i>				
	<i>Capture, Store, Manage, View, Share images</i>				
	<i>Manage Needs of Each Department</i>				

<i>Monitors miminum 27" HD DICOM Preset (3 Sets Units minimum )</i>				
<i>PC XEON or i7 CPU (3 Sets Units minimum )</i>				
<i>Graphic Card and UPS (3 Sets Units minimum )</i>				
<i>4TB Independent Server (1 Sets Unit minimum )</i>				
<i>ACR BI-RADS Atlas 5th Edition or later version</i>				
Breast composition				
Tissue composition (screening only)				
Architectural distortion				
Amount of fibroglandular tissue (FGT)				
<i>Kinetic curve assessment Signal intensity (SI)/time curve description</i>				
<i>Non-mass enhancement (NME)</i>				
<b>Gjithësej:</b>			<b>250.000,00</b>	<b>270.000,00</b>

Komisioni I hartimit të paramasës dhe specifikave:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

#### DOKUMENTACIONI I KËRKUAR:

1. Vërtetim – Deklaratë (valide) nga Prodhuesi që Pajisjet dhe Uppgrade janë origjinale me tipin e dixhitalizerit që posedon QKMF në Drenas, për Rentgenin ekzistues FDR Smart FGXR-FujiFilm dhe për dixhitalizerin ekzistues FujiFilm-PRIMA TM. (me shënime të tenderit valide) – Kopje e Noterizuar
2. Garancia 12 muaj nga Prodhuesi. – Kopje e Noterizuar
3. Duhet të posedojnë certifikatat CE, ISO. – Kopje e Noterizuar
4. Certifikata e Serviserit të trajnuar nga Prodhuesi për funksionalizim dhe servisim (së paku 2) – Kopje e Noterizuar
5. Të dëshmohet se OE ka liqence nga AKPM si qarkullues me shumicë për pajisje medicinale (me validitet) – Kopje e Noterizuar
6. ISO 9001:2015 për OE (Për shitje dhe servisim të pajisjeve mjekësore) – Kopje e Noterizuar
7. Instalimi dhe leshuarja në punë e aparatit, Trajnimi i stafit teknik dhe emjekësor për përdorim të Sistemit.
8. Vërtetimi nga prodhuesi që Koha e Liferimit duhet të jetë: 45 ditë. – Kopje e Noterizuar
9. Katalogu i nenvizuar për pajisjet e ofruara me kodet e prodhuesit përkatës,
10. Oferta nga OE me kodet e prodhuesit dhe emra përkatës në detaje sipas specifikimit të kërkuar.
11. Operatori është i obliguar të bëjë instalimin e pajisjeve, passwordeve nga prodhuesi, duke përfshirë titrimin e IP, vendosjen e Licencave (OE është i obliguar të vendosë të gjitha ato që mungojnë), lidhjen e pajisjeve dhe monitimin.
12. Listen e kontratave të realizuara të natyrës së ngjashme dhe së paku 3 referenca pozitive.



## SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT

Për: **KOMUNA GLOGOC**  
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

Në emër të: **KosovaMed Healthcare SH.P.K.**, Rr. Muharrem Fejza, Komp.Royal, Hy.C15/13, Nr.4 Prishtine  
(në vazhdim "operatori ekonomik").

Titulli i aktivitetit të prokurimit dhe Numri i prokurimit: Titulli : Furnizim me paisje mjekësore për shërbimin e radiologjisë

611-22-4515-1-1-1 611-22-040-111

### Garancion me kërkesë të parë

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri;

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **Njzet e Shtate mijë 27,000.00 €** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **27,000.00 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejt që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin 'e pranimit'.

Kjo siguri është e vlefshme **75 ditë** prej **16.08.2022** deri më **30.10.2022**

Garancioni në fjalë skadon tërësisht dhe në menyrë automatike nëse kërkesa e juaj nuk ka arritur në K.S "SIGKOS" sh.a më së voni deri në datën e shënuar më lartë.

  
Nënshkrimi dhe vulë e Garantuesve  
  
Emri i bankës ose i institucionit financiar  
**K.S. "SIGKOS" Sh.a.**  
Lagjia Kalabria, Kompleksi Riera, Hyrja Z10, Magjistralja  
Prishtinë-Shkup, 10000 Prishtinë, Kosovë

Data  
16.08.2022



Dega	Qendra
------	--------

Numri i polices	060010150084984
-----------------	-----------------

**1 Të dhënat për agentin - Agent details**

Emri dhe mblemri	Adresa	Nr. i tel	Nr. ID
Besa Haxhimehmeti	Sigkos, Qendra	038 22 32 18	001015

**2 SIGURUESI / Garantuesi: Kompania e Sigurimit " SIGKOS " sh.a., Prishtinë**

I SIGURUARI	KosovaMed Healthcare SH.P.K.		
Adresa	Rr. Muharrem Fejza, Komp.Royal, Hy.C15/13, Nr.4 Prishtine		
Përfaqësuar nga Z.	Kastriot Asllani	Nr. i biznesit	810866759

**3 Siguruesi dhe i siguruari me vullnet të lirë , të barabartë dhe me mirëbesim lidhin këtë lloj sigurimi.**

Përshkrimi i mbulesës siguruese / Garancisë - Lloji:	SIGURIMI I EKZEKUTIMIT TË TENDERIT
Titulli : Furnizim me pajisje mjekësore për shërbimin e radiologjisë 611-22-4515-1-1-1 611-22-040-111	

a) Sigurimi i tenderit, Ekzekutimi i tenderit, Sigurim tjetër b) Titulli i mbulesës siguruese, c) Numri i prokurimit, etj.

Përfituesi	KOMUNA GLLOGOC
Adresa	RR FEHMI LLADROVCI
Shuma e siguruar €	27,000.00 €

**4 LËNDA E GARANCISË: Detyrimet e Palëve sipas kësaj Pollice të Sigurimit janë:**

- Mbështetur në këtë Policë- Garancie, Siguruesi/Garantuesi merrë përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktor i cili është i garantuar me këtë Pollicë.
- Efekt i veprues i kësaj Pollice - Garancie, që do të thotë fillimi i detyrimit të Siguruesit / Garantuesit fillon mbas përfundimit të afatit të fundit të përcaktuar në marrëveshjet dhe/ose kontratat e lidhura në mes të Siguarit/Kontraktuesit dhe Përfituesit që sjellin detyrimet kontraktore për kontraktuesin, që do të thotë se Përfituesi nuk mund të paraqes kërkesa në zbatim të kësaj Pollice kur Kontraktuesi është brenda afatit për pëmbushjen e detyrimeve të tij ndaj Përfituesit sipas dispozitave në fuqi.
- Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit/Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të Siguarit/ Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
- Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj Përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi tek Siguruesi / Garantuesi)


Periudha e sigurimit/garancisë	Fillon me: 16.08.2022	Mbaron me: 30.10.2022
--------------------------------	-----------------------	-----------------------

**5**

Shuma e siguruar	Primi neto €	TVSH	Primi total €
27,000.00 €	486.00 €	87.48 €	573.48 €

Ky Sigurim është lidhur sipas Kushteve të Përgjithshme të Sigurimit të Garancive të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Pollice.

Primi i sigurimit paguhet tërësisht / Premium is paid completely	573.48 €	Data / Date	16.08.2022	Me këtë: Numri i kësaj Pollice / In Installments / Nr. of inst.	
Shënime tjera:					
I Siguarit / The Insured	Data e lëshimit / Issued date	Siguruesi / The Insurer			
Kastriot Asllani	16.08.2022	Besa Haxhimehmeti			





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of  
Komuna e PRISHTINË / Opština PRIŠTINA / Municipality



Bazuar në nenin 18 të ligjit 03/L-204 për tatimin në pronë, si dhe udhëzimit administrativ nr. 7/2011 të lëshuar nga MF, i cili ka të bëjë me urdhëresat e ndalimit të shërbimeve komunale për detyrim të pagesës së tatimit në

Na osnovu člana 18, zakona 03/L-204 za poreza na imovinu i administrativne uredbe MF br. 7/2011, u vezi zabrane opštinskih usluga za prinudu uplate poreza na imovinu, izdaje se ova:

Based on the article 18 of LAW 03/L-204 on property tax and administrative instruction MF no. 7/2011 on termination of services for enforcement of the municipal property tax, the municipal Property Tax Office

Nr / Br / No 138241/22  
92003088131

16/06/2022

## VËRTETIM POTVRDA CERTIFICATE

Me të cilin vërtetohet se tatimpaguesi  
Kojim se potvrduje da je poreznik  
that certifies that taxpayer

KASTRIOT ASLLANI

PRISHTINË  
Komuna / Opština / Municipality

PRISHTINË HILMI RAKOVICA HY-1 K-3 NR-  
adresa / adresa / address

I ka kryer pjesërisht / plotësisht obligimet e tatimit në pronë  
Delimično/ izveršio uplatu poreskih obaveza  
has partially / fulfilled obligations on property tax

KOSOVAMED HEALTHCARE SHPK


Vërtetimi lëshohet në bazë të kërkesës së / Potvrda se izdaje na zahtev / Certificate is issued by

Shërbime të ZKK

dhe shërben për / i služi za / and is used for

Per Tender

Shënime shtesë / Druge podatke / Additional info



Nenshkrimi / Potpis / Signature



VËRTETIM TATIMOR  
TAX VERIFICATION  
PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:  
Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:  
Poreska Administracija Kosova overava da dolje identifikaciono lice:



1000910045

Emri i personit: Name of Person: Ime lice:	KosovaMed Healthcare SH.P.K.
Numri Identifikues Personal: Personal Identification Number: Identifikacioni Lični Broj:	_____
Numri Fiskal: Fiscal Number: Fiskalni Broj:	810866759
Komuna: Municipality: Opština:	PRISHTINË
Data: Date: Datum:	07.06.2022
Arsyeja e lëshimit: Reasoning: Razlog izdavanja:	Aplikim për Tender

ka këtë gjendje tatimore në ATK:  
has the following tax position with the TAK:  
ima sledeću poresko stanje u PAK:

Personi është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhe tatimore të mbetura  
This person is registered with TAK and is currently in an installment agreement to satisfy outstanding tax debts

Lice je registrovana u PAK i aktuelno je u sporazumu u ratama za isplatu ostalih poreskih dugova

ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, mirëpo, ky vërtetim nuk përjashton obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.

ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.

PAK overava da su date informacije tačne i potpune sa datumom ove potvrde, ali ova potvrda ne isključuje poreska obaveza koja mogu nastati u budućnosti.

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit  
The verification is valid for 90 days from the day it is issued  
Potvrda vazl 90 dana od dana kada je izdata

Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun -  
Verification of this tax verification, you can do on the link - Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uveravati i linku:  
<https://eVertetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer>



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



GJYKATA THEMELORE Prishtinë  
OSNOVNI SUD

- DEGA Prishtinë  
- OGRANAK

Me kërkesë të Kastriot (Xhavit) Asllani , Nr.personal 1009558132 , i lindur me 09.12.1983  
Na zahtev Lični Br. Datum rođenja

në Gjakovë , me vendbanim në Prishtinë , lëshon këtë:  
u sa prebivalištem u izdaje ovu:

**CERTIFIKATË**

NGA EVIDENCA E PERSONAVE KUNDËR TË CILËVE ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURA PENALE DHE PERSONAVE TË DËNUAR NGA KJO GJYKATË

**UVERENJE**

IZ EVIDENCIJE LICA PROTIV KOJH SE VODI KRIVIČNI POSTUPAK I OSUĐENIH LICA OD OVOG SUDA

Me të cilën konfirmon se kundër parashtresit të kërkesës , si person fizik Kastriot (Xhavit) Asllani  
Kojom se potvrđuje da se protiv podnosioca zahteva, kao fizičkog lica

Me të cilën konfirmon se kundër parashtresit të kërkesës , sj person juridik  
Kojom se potvrđuje da se protiv podnosioca zahteva, kao pravnog lica

1. Nuk është duke u zhvilluar procedurë penale.   
Ne vodi krivični postupak.

2. Është duke u zhvilluar procedura penale sipas lëndës P.nr. \_\_\_\_\_  
Vodi krivični postupak po predmetu K.br. \_\_\_\_\_

për veprën penale/za krivično delo \_\_\_\_\_  
nga neni/ iz člana \_\_\_\_\_ i KPRK –së/ KZRK-a

3. Nuk është i dënuar.   
Nije kažnjen.

4. Është dënuar me Aktgjykim të formës së prerë nr./Kažnjen je pravosnažnom presudom br. \_\_\_\_\_  
datë/dana \_\_\_\_\_ , me dënim/ kaznom \_\_\_\_\_ , në kohëzgjatje prej/ u trajanju od \_\_\_\_\_  
ose gjobë në shumë prej/ ili novčanom kaznom u visini od \_\_\_\_\_

5. Dënimi i shqiptuar është ekzekutuar  , është ne fazën e ekzekutimit  , nuk është ekzekutuar ende  .  
Izrečena kazna je izvršena, nalazi se u fazi izvršenja, nije izvršena.

Vërejtje

Primedba

Kjo Certifikatë mund të përdoret për: Tender

Ovo Uverenje se može koristiti u svrhu

PN. NR/KR.Br 9190/2022

Data/Datum 10.05.2022

Referenti\ Personi i autorizuar (Emri mbiemri dhe nënshkrimi) dhe vula  
Referent\Ovšćeno lice (ime, prezime i potpis) i pečat





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË  
OSNOVNI SUD PRISHTINA

DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE  
DEPARTMAN ZA EKONOMSKA PITANJA



Agj.nr. 2412/2022

Me datë –Datuma 10.05.2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Ekonomike, në bazë të OSNOVNI SUD U PRIŠTINI-Departman za privredna pitanja, na osnovu zahteva stranke, u smislu kërkesës së palës, në kuptim të nenit 12 paragrafi 2.10 i Rregullores për Organizimin e Brendshëm çlana 12, stav 2.10 Pravidnika o unutrašnjoj organizaciji të Gjykatave e datës 4.1.2013, lëshon këtë:  
Sudova izdaje sledeće:

## ÇERTIFIKATË

### UVERENJE

Në regjistrat e Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë,  
U regjistrua Departmana za privredna pitanja Osnovnog suda u Prištini  
Nuk ka - evidencë se operatori ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K. Prishtinë, me numër biznesi 810866759.

*nema dokaza da je ekonomski operater*

Nuk është - shpallur i falimentuar ose insolvent gjatë dy viteve të kaluara, dhe ndaj të njëjtit  
*Nije proglašen pod stečaj ili nelikvidan u protekle dve godine, i protiv istog*

nuk është - e iniciuar procedura e falimentimit përkatësisht e likuidimit  
*nije – pokrenut postupak stečaja odnosno raspuštanja /likvidacije/.*

Kjo Çertifikatë lëshohet në kuptim të nenit 65 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1 dhe 4.2 i Ligjit  
Uverenje izdaje se na osnovu člana 65 stav 4 podstav 4.1 i 4.2 Zakona  
Nr.04/L-042 për Prokurorimin Publik në Republikën e Kosovës.  
*br.04/L-042 o Javnoj Nabavci Republike Kosova.*

E njëjta është kërkuar nga pala me qëllim të pjesëmarrjes në **Tender**,  
*Ista je tražena od stranke, sa ciljem učešća u tenderu*

dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera.  
*i ne može se upotrebiti za druge svrhe.*

Taksa është paguar sipas Tarifës për taksa gjyqësore në shumë prej 5 €, e paraparë me nenin 12.17  
*Taksa je plaćena po Tarifi za sudske takse u iznosu od 5 €, predviđeno članom 12.17*

të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së, nr. 1/2017, në fuqi nga data 1.5.2017.  
*Administrativnog Upustva SSK-a, br. 1/2017, na snazi od dana 1.5.2017god.*

Referenti i Gjykatës  
Referent Suda  
Afrim Ademi